

NJOFTIM PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT, Z. ÇLIRIM SHAHINI

03/26/2019

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore më datë 21.03.2019 për subjektin e rivlerësimit, z. Çlirim Shahini, bazuar në ligjin nr. 84/2016, sot, më datë 26.03.2019 vendosi:

Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, Çlirim Shahini, drejtues i Prokurorisë së Rrethit Lushnjë.

Vendimi i arsyetuar me shkrim nga trupi gjykues e kryesuar nga znj. Brunilda Bekteshi, znj. Xhensila Pine relatores, znj. Suela Zhegu anëtare, do t'u njoftohet subjektit të rivlerësimit, komisionerëve publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve .

Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.